

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.4489, datë 6.5.2010

**PËR FURNIZIMIN NGA RAFINERITË DHE SHOQËRITË E TREGTIMIT ME
SHUMICË TË LËNDËS DJEGËSE QË NUK PËRDORET PËR AUTOMJETE
RRUGORE DHE GJENERATORË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 12,14,23 dhe 24 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.170, datë 29.3.2006 “Për ngjyrosjen e lëndës djegëse për automjetet me motor diesel, si dhe të lëndës djegëse, që importohet për qëllime industriale e publike”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, të kreut V të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pjesës XIII të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1.Subjektet e pajisura me lejet/licencat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, të cilat prodhojnë dhe/ose importojnë lëndë djegëse, për qëllime industriale dhe publike, që në nomenklaturën e mallrave nuk përfshihen në lëndë djegëse për automjetet rrugore dhe gjeneratorë (me kod 27101941, me cilësi sipas standardit S.Sh.EN 590, dhe me përmbajtje squfuri deri në 350 mg/kg deri me 31.12.2010, si dhe lëndë djegëse me cilësi sipas standardit S.Sh.EN 228) do të prodhojnë brenda vendit, importojnë dhe tregtojnë këto produkte të cilat të kenë destinacion përdorimi të ndryshëm nga tregtimi për automjete rrugore dhe gjeneratorë, vetëm pasi të jenë denatyruar duke u ngjyrosur me bojë sipas përcaktimit në pikën 2.

2.E gjithë sasia e prodhuar në vend dhe/ose importuar, denatyrohet duke u ngjyrosur me bojë të kuqe sipas standardit të BE-së. Niveli i ngjyrimit duhet të jetë jo më ak se 9 mg/l lëndë djegëse. Ngjyrosja është detyrim i subjekteve prodhues dhe/ose importues dhe kryhet:

-Për prodhuesin, në depon e nënprodukteve të naftës, të miratuar si magazina tatimore nga organi tatimor, sipas kërkesës së personit të autorizuar si tatimpagues akcize.

-Për importuesin në magazinën doganore përpara se malli të hidhet në qarkullim të lirë.

Ngjyrosja do të kryhet në prezencën e inspektorit/eve të IQT-së dhe autoritetit doganor/tatimor, nën juridiksionin e të cilëve është subjekti. IQT kryen procedurat e marrjes së mostrave dhe të analizës së mallit dhe lëshon certifikatën përkatëse.

3.Organi tatimor dhe/ose doganor do të kryejë procedurat për lejimin e tregtimit dhe/ose zhdoganimit të lëndës djegëse për qëllime industriale dhe publike, me emërtimin e kodeve dhe cilësisë sipas pikës 1, pasi subjekti të paraqesë certifikatën e cilësisë së mallit të lëshuar nga IQT dhe konfirmimin për ngjyrosjen e tij sipas pikës 2.

4.Përjashtohen nga zbatimi i këtij udhëzimi lëndët djegëse të kategorisë V, neni 10 i ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

5.Ky udhëzim hyn në fuqi 2(dy) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Dritan Prifti**

**MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode**